



## VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

**Data e miratimit:** 23 nëntor 2011

**Numri i lëndës** 2011-15

**z. Samedin Smajli**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 1 maj 2011. Ankesa është parashtruar në emër të ankuesit nga anëtari i familjes.

### II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmblidhen si në vijim.

### *Parathënie*

3. Më 24 qershor 2010 në ndërtesën e Komunës së Skenderajt kishte ndodhur një incident me të shtëna. Ishin përfshirë parashtruesi i ankesës Samedin Smajli, kushëriri i tij Avdyl Smajli dhe katër (4) persona të tjera. Sipas parashtruesit të ankesës, kushëriri i tij kishte përdorur armën për ta mbrojtur veten prej këtyre katër personave të tjera të cilët gjithashtu ishin të armatosur. Tre prej këtyre katër personave të tjera u plagosën.
4. Më 9 korrik 2010 parashtruesi i ankesës dhe kushëriri i tij ishin arrestuar, kurse asnjëri prej këtyre katër (4) personave të tjera që ishin të përfshirë nuk ishte arrestuar. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo kishte ndodhur për shkak të një rasti të korruptionit brenda sistemit ligjor.
5. Në të njëjtën ditë një gjykatës i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës kishte lëshuar një vendim për paraburgim një (1) mujob duke u bazuar në dyshimin për tentative vrasje të rëndë dhe posedim të paligjshëm dhe përdorim të armëve kundër parashtruesit të ankesës dhe vëllait të tij. Prej atëherë, parashtruesi i ankesës nuk ma marrë asnjë njoftim në lidhje me zhvillimin e procedurave.
6. Sipas parashtruesit të ankesës, ai dhe kushëriri i tij janë ende në paraburgim, më shumë se pesëmbëdhjetë (15) muaj më vonë pa aktakuzë.

### *Kontakti me EULEX-in*

7. Më 11 mars 2011 anëtari i familjes së parashtruesi i ankesës ka dërguar një letër tek Shefi i Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it. Ai kishte kérkuar nga EULEX-i që të ndërhyj për shkak se "EULEX-i merret me korruption dhe kujdeset që procedurat gjyqësore të trajtohen në një mënyrë legjitime".
8. Më 1 prill 2011 ai kishte marrë një përgjigje nga zyrtari ligjor i EULEX-it nga zyra e shefit të drejtësisë. EULEX-i kishte deklaruar se trajtimi i ankesave apo kérkesave për këshilla ligjore nga personat nuk bie në kuadër të mandatit të EULEX-it. Asnjë shpjegim apo njoftim tjetër nuk ishte dhënë për parashtruesin e ankesës.

### *Informata shtesë*

9. Më 26 tetor 2011 Paneli ka paraqitur një kérkesë për informatë tek Shefi i Misionit të EULEX-it.
10. Më 15 nëntor 2011 zyra e Shefit të Drejtësisë në EULEX ka ofruar informata rreth procedurave penale në fjalë tek Paneli:
  - a) *Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 9 dhjetor 2010 dhe ajo ishte vërtetuar më 20 janar 2011 nga një gjykatës vendor në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.*

- b) Më 15 qershor 2011 EULEX kishte marrë përsipër lëndën (në përputhje me kriterin e përcaktuar në Ligjin mbi Kompetencat, Përgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-in në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053)).
- c) Rasti tani është duke u përgatitur për gjykim kryesor. Gjyki është i caktuar për datën 5 deri 8 dhjetor 2011. Trupi gjykues do të përbëhet nga tre gjykatës të EULEX-it.
- d) Prokurori i EULEX-it gjithashtu ishte i pranishëm në seancën e marrjes përsipër të lëndës, kështu që zyra e prokurorisë publike të qarkut të EULEX-it tashmë është e njofuar rreth kësaj.

### **III. ANKESAT**

11. Parashtruesi i ankesës pohon se procedurat hetimore dhe gjyqësore nuk janë zhvilluar në mënyrë të pavarur dhe të drejtë. Ai kërkon që EULEX-i duhet të merr përsipër lëndën siç parashihet në Ligjin mbi Kompetencat, Përgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053).

### **IV. LIGJI**

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës (RrP).
13. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana siç përcaktohen në Rregullës 25, paragrafi 1 të RrP.
14. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhëniec në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë pranë gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përvçese apo nëse ata do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.
15. Pra së gjithash, Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës nuk pretendon se është viktimi e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it. Parashtruesi i ankesës faktikisht kërkon që EULEX-i ta merr lëndën përsipër. Kjo është bërë në bazë të vendimit të dafës 15 qershor 2010 të përmendur më lart.
16. Për më tepër, aktakuza rreth rastit është ngritur pranë një gjykate dhe se rasti tani është duke u përgatitur për gjykim. Ankesa ka të bëjë me

procedura gjyqësore pranë një gjykate të Kosovës. Fakti se rasti është marrë përsipër nga EULEX-i sipas dispozitave të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053) nuk e largon faktin se veprimet e gjykatave të përbëra plotësisht nga gjykatësit e EULEX-it mbresin gjykata të Kosovës. Paneli konstaton se nuk ka të drejtë të rishqyrton procedurat gjyqësore (siç përmendet më lart, parografi 14). Prandaj, ankesa nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit.

17. Për më tepër, Paneli në kalim e sipër konstaton se personi i cili ka parashtruar ankesën, nuk ka ofruar dokumente të nevojshme për të vërtetuar aftësitë e tij për të përfaqësuar ankuesin siç parashihet në Rregullën 2, parografi 5 i RrP. Sidoqoftë, nëse në të ardhmen ankuesi dëshiron që të parashtroj një ankesë në emrin e tij për të pretenduar se të drejtat e njeriut të tij janë shkelur nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, ai mund të parashtroj një ankesë të re tek Paneli apo përmes një përfaqësuesi të autorizuar sipas Rregullës 25, paragrafi 5 dhe Rregulla 17 (a) të RrP<sup>1</sup>.

## PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

*konstaton se nuk ka kompetenca për ta shqyrtuar ankesën,*

*gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Regullores së vet të Punës, dhe*

## SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit

<sup>1</sup> Rregulla 25, paragrafi 1 i Regullores së Punës: 1. Ankesa mund të parashistrohet nga një person përpos personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv [...].

Rregulla 25, paragrafi 5 i Regullores së Punës: Atëherë kur ankuesi përfaqësohet në përputhje me dispozitat Rregullës 17, një dokument që vërteton aftësinë e tij/e saj për të përfaqësuar ankuesin duhet të durohet në Panel nga përfaqësuesi.



## VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

**Data e miratimit:** 23 nëntor 2011

**Numri i lëndës** 2011-16

**z. Avdyl Smajli**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 1 maj 2011. Ankesa është parashtruar në emër të ankuesit nga anëtari i familjes.

### II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmblidhen si në vijim.

### *Parathënë*

3. Më 24 qershori 2010 në ndërtesën e Komunës së Skenderajt kishte ndodhur një incident me të shtëna. Ishin përfshirë parashtruesi i ankesës Avdyl Smajli, kushërimi i tij Samedin Smajli dhe katër (4) persona të tjera. Sipas parashtruesit të ankesës, ai kishte përdorur armën e tij për ta mbrojtur veten dhe kushërimin e tij prej këtyre katër personave të tjera të cilët gjithashtu ishin të armatosur. Tre prej katër personave të tjera u plagosën.
4. Më 9 korrik 2010 parashtruesi i ankesës dhe kushërimi i tij ishin arrestuar, kurse asnjëri prej këtyre katër (4) personave që ishin të përfshirë nuk ishte arrestuar. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo kishte ndodhur për shkak të një rasti të korruptionit brenda sistemit ligjor.
5. Në të njëjtën ditë një gjykatës i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës kishte lëshuar një vendim për paraburgim një (1) mujob duke u bazuar në dyshimin për tentative vrasje të rendë dhe posedim të paligjshëm dhe përdorim të armëve kundër parashtruesit të ankesës dhe kushërit të tij. Prej atëherë, parashtruesi i ankesës nuk ma marrë asnjë njoftim në lidhje me zhvillimin e procedurave.
6. Sipas parashtruesit të ankesës, ai dhe kushërimi i tij janë ende në paraburgim, më shumë se pesëmbëdhjetë (15) muaj më vonë pa aktakuzë.

### *Kontakti me EULEX-in*

7. Më 11 mars 2011 anëtari i familjes së parashtruesi i ankesës ka dërguar një letër tek Shefi i Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it. Ai kishte kërkuar nga EULEX-i që të ndërhyj për shkak se "EULEX-i merret me korruption dhe kujdeset që procedurat gjyqësore të trajtohen në një mënyrë legitime".
8. Më 1 prill 2011 ai kishte marrë një përgjigje nga zyrtari ligjor i EULEX-it nga zyra e shefit të drejtësisë. EULEX-i kishte dekluar se trajtimi i ankesave apo kërkeseve për këshilla ligjore nga personat nuk bie në kuadër të mandatit të EULEX-it. Asnjë shpjegim apo njoftim tjetër nuk ishte dhënë për parashtruesin e ankesës.

### *Informata shtesë*

9. Më 26 tetor 2011 Paneli ka paraqitur një kërkësë për informatë tek Shefi i Misionit të EULEX-it.
10. Më 15 nëntor 2011 zyra e Shefit të Drejtësisë në EULEX ka ofruar informata rrëth procedurave penale në fjalë tek Paneli:
  - a) *Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 9 dhjetor 2010 dhe ajo ishte vërtetuar më 20 janar 2011 nga një gjykatës vendor në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.*

- b) Më 15 qershor 2011 EULEX kishte marrë përsipër lëndën (në përputhje me kriterin e përcaktuar në Ligjin mbi Kompetencat, Përgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-in në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053)).
- c) Rasti tani është duke u përgatitur për gjykim kryesor. Gjyktimi është i caktuar për datën 5 deri 8 dhjetor 2011. Trupi gjykues do të përbëhet nga tre gjykatës të EULEX-it.
- d) Prokurori i EULEX-it gjithashtu ishte i pranishëm në seancën e marrjes përsipër të lëndës, kështu që zyra e prokurorisë publike të qarkut të EULEX-it tashmë është e njoftuar rreth kësaj.

### **III. ANKESAT**

11. Parashtruesi i ankesës pohon se procedurat hetimore dhe gjyqësore nuk janë zhvilluar në mënyrë të pavarur dhe të drejtë. Ai kërkon që EULEX-i duhet të merr përsipër lëndën siç parashihet në Ligjin mbi Kompetencat, Përgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053).

### **IV. LIGJI**

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojnë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës (RrP).
13. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana siç përcaktohen në Rregullës 25, paragrafi 1 të RrP.
14. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e Ilogaridhëniec në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë pranë gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përvçese apo nëse ata do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.
15. Pra së gjithash, Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës nuk pretendon se është viktimi e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it. Parashtruesi i ankesës faktikisht kërkon që EULEX-i ta merr lëndën përsipër. Kjo është bërë në bazë të vendimit të datës 15 qershor 2010.
16. Për më tepër, aktakuza rreth rastit është ngritur pranë një gjykate dhe se rasti tani është duke u përgatitur për gjykim. Ankesa ka të bëjë me

procedura gjyqësore pranë një gjykate të Kosovës. Fakti se rasti është marrë përsipër nga EULEX-i sipas dispozitave të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 L/053) nuk e largon faktin se veprimet e gjykatave të përbëra plotësisht nga gjykatësit e EULEX-it mbresin gjykata të Kosovës. Paneli konstaton se nuk ka të drejtë të rishqyrton procedurat gjyqësore (siç përmendet më lart, parografi 14). Prandaj, ankesa nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit.

17. Për më tepër, Paneli në kalim e sipër konstaton se personi i cili ka parashtruar ankesën, nuk ka ofruar dokumente të nevojshme për të vërtetuar aftësitë e tij për të përfaqësuar ankuesin siç parashihet në Rregullën 2, parografi 5 i RrP. Sidoqoftë, nëse në të ardhmen ankuesi dëshiron që të parashtroj një ankesë në emrin e tij për të pretenduar se të drejtat e njeriut të tij janë shkelur nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, ai mund të parashtroj një ankesë të re tek Paneli apo përmes një përfaqësuesi të autorizuar sipas Rregullës 25, parografi 5 dhe Rregulla 17 (a) të RrP<sup>1</sup>.

## PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

*konstaton se nuk ka kompetenca për ta shqyrtuar ankesën,*

*gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Regullores së vet të Punës, dhe*

## SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit



<sup>1</sup> Rregulla 25, paragrafi 1 i Regullores së Punës: 1. Ankesa mund të parashtrohet nga një person përpos personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili pretendon se është viktimi e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv [...].

Rregulla 25, paragrafi 5 i Regullores së Punës: Atëherë kur ankuesi përfaqësohet në përputhje me dispozitat Rregullës 17, një dokument që vërteton aftësinë e tij/e saj për të përfaqësuar ankuesin duhet të durohet në Panel nga përfaqësuesi.